

Pyetje nga takimi informues Shkodër

A ka prioritet partneriteti me OSHC që ndodhen në bazën e të dhënave të publikuar nga GreenAL?

Jo, partneriteti me këto organizata nuk ka prioritet. Baza e të dhënave është hartuar me qëllim për t'i ardhur në ndihmë organizatave që duan të aplikojnë dhe nuk kanë kontakt me organizata jashtë bashkisë apo rajonit në të cilin operojnë.

A mund të kemi partneritet me institucionet në nivel bashkiak dhe kombëtar?

Po, partneriteti me institucione është i lejuar dhe futen në kategorinë e partnerëve pa buxhet.

A mund të konsiderohet ndërhyrja në territor (p.sh. hapje shtegu) si një investim i lejuar sa i përket granteve Rajonale?

Investime të këtij lloji janë të lejuara varësisht nga tematika e trajtuar, dhe këto investime duhet të lidhen ngushtësisht me zgjidhjet e propozuara apo mitigimin e problematikës

A mund të aplikoj në këtë thirrje nëse nuk kam eksperiencë të mëparshme në fushën e mjedisit?

Nëse kërkon të aplikoni si aplikant kryesor ju duhet ta keni me patjetër të cituar në statut që organizata juaj ka fokus në çështjet mjedisore. Nëse kërkon të aplikoni si bashkë aplikant duhet të keni eksperiencë të mëparshme në projekte mjedisore të listuara në CV-në e organizatës.

A mund të aplikoj në këtë thirrje nëse organizata ka më pak se 5 vite që është regjistruar?

Në rast se organizata juaj ka më pak se 5 vite që është regjistruar, ju nuk mund të aplikoni si aplikant kryesor në këtë thirrje. Ndërsa për të aplikuar si bashkë-aplikant, organizata duhet të ketë minimalisht 1 vit e regjistruar në gjykatë si OJF.

A ka raporte të përcaktuar për shpërndarjen e buxhetit?

Jo, nuk ka raporte të përcaktuara mes zërave, megjithatë raporti i shpenzimeve të propozuara duhet të ketë një logjikë dhe të jetë i shpërndarë.

A është TVSH kosto e pranueshme?

Në rastin e TVSH, donatorët nuk e pranojnë si kosto të projektit dhe shteti Shqiptar nuk e rimbursion. Taksat e vlerës së shtuar nuk janë të rimbursueshme në asnjë mënyrë. Ato do të përballohen nga përfituesi dhe duhet të pasqyrohen qartë në projekt propozim.

Nëse nënshkruhet marrëveshje bashkëpunimi me një entitet publik/privat (universitet) mund të nënshkruhet kontratë me pedagogë si ekspert të jashtëm, të cilët nuk janë entitet juridik më vete?

Bashkëpunimi me entitete publike është i hapur për tu zhvilluar në formën e aplikantit pa buxhet, vlerësimi për përfshirjen ose jo të tyre mbetet në gjykimin e aplikantit kryesor dhe/ose bashkë aplikantëve. Përzgjedhja e ekspertëve të cilet do të përfshihen në projekt (parashikuar si staf i

projektit në buxhet) do të duhet të vlerësohet mirë nga aplikuesi kryesor për të shmangur konfliktin e interesit, ndërmjet ekspertit dhe institucionit me të cilin po bashkëpunon aplikuesi/partneriteti.

Pyetje nga takimi informues Tiranë

Sa është vlera e investimit?

Tek LOT 2 lejohet kryerja e investimeve deri në 25% të buxhetit total të kërkuar. Mos parashikimi i kryerjes së investimeve nuk është kriter penalizues.

Kur flasim për alikantët pa buxhet a ka nevojë të lidhim kontratë apo akt marrëveshje apo vetëm të deklarohen?

Qofshin aplikantët pa buxhet qofshin bashkë aplikant duhet të ketë një marrëveshje bashkëpunimi me të gjithë rrjetin e organizatave, ku të përcaktohet me aq sa mundet të specifikohet, arsya përse është zgjedhur ky aplikant, roli i tyre dhe vlera e shtuar. Do të dëshironim që të gjitha këto të jenë të specifikuar në marrëveshjen e bashkëpunimit.

Nëse në qarkun ku unë operoj nuk ka organizata aktive ose janë të angazhuara në partneritete të tjera a mund të bashkëpunojë me OSHC të cilat operojnë jashtë rajonit në të cilin do të zbatohet projekti?.

Nëse ju e justifikoni dhe sqaroni arsyen përse ju keni zgjedhur të operoni me nje organizatë nga një qark tjetër dhe vlerën e shtuar që sjell kjo organizatë, bashkëpunimi nuk do të jetë penalizues.

Kur bëhet fjalë për grantet rajonale me vlerë 50'000 euro, a është kjo vlerë vetëm për organizatën kyesore apo për te gjithë partneritetin? A është e përcaktuar sa peshë do të zërë aplikanti kryesor dhe sa peshë do të kenë partnerët?

Vlera prej 50'000 Euro është për të gjithë partneritetin dhe nuk është e përcaktuar sa do të jetë vlera specifike për secilin partner.

Në udhëzuesin për grante përmëndni se nuk lejohen veprime që kanë të bëjnë vetëm ose kryesisht me sponsorizime individuale për pjesëmarrje në seminare, konferenca/kongrese ndërsa me pas parashikoni hartimin e letrave të pozicionimit, artikuj shkencor të cilët kryesisht publikohen në revista apo forume ndërkombëtare? Si mund të veprojmë në këtë rast?

Nuk lejohen veprime apo aktivitete të cilat janë ngushtësisht të lidhura me përfitime personale, p.sh. realizimi i një doktorature. Lejohet publikimi i artikujve edhe në revista ndërkombëtare por studimi të jetë i lidhur ngushtësisht me projektin e zbatuar dhe të parashtrahet vlera e shtuar që sjell ky botim.

A lejohen investimet tek grantet tematike?

Jo, tek grantet tematike nuk lejohen investimet.

Për LOT 1, grantet tematike, është parashikuar që tre grantet tematike të jenë nga një për çdo temë, një për natyrën, një për ndotjen dhe një për ndryshimet klimatike? A do të jetë kusht përzgjedhjeje?

Hipotetkisht nëse do të ketë aplikime të cilat plotësojnë kushtet, dëshira jonë është që grantet tematike të jenë tre, një për secilen temë, por nuk do të jetë kusht skaulifikimi.

Në pikën tre për ndotjen ju i referoheni vetëm monitorimit të ajrit, nëse do të fokusohet dikush tek çështjet e ndotjes a do të duhet domosdoshmërisht të merret vetëm me ajrin, ndërkohë që ndotja është shumë e gjërë si koncept dhe mund të ketë propozime për elementë të tjerë të ndotjes së mjedisit?

Monitorimi i ajrit do të bëhet si pjesë e vazhimit të punës që Co-PLAN bashkë me organizatat e tjera e ka filluar që në vitin 2017, monitorimi i ajrit dhe zhurmës në 5 qytete të Shqipërisë, (greenlungs.al). Co- PLAN në bashkëpunim me organizatat partnere po gjithashtu edhe me Ambasadën dëshiron që këtë çështje ta çojë përpara. GreenAL ka blerë pajisjet të cilat do ti huazohen organizatës fituese, për të aplikuar metodologjinë dhe për çuar këtë nismë në një nivel tjetër. Për më tepër, fondet në dispozicion për grantet tematike japin hapësirë për të zgjeruar monitorimin përtej ndotjes së ajrit. Do të varet gjithcka nga mënyra si do të pasqyrohet nisma.

Nëse do merret në konsideratë mbjellja e pemëve për nismat e granteve rajonale a do të konsiderohet shpenzimi për to tek 25% investimit?

Po, gjithashtu është e rëndësishme që aplikantët të cilët do të zgjedhin të kryejnë investime konkrete duhet të sigurohen që ky investim të jetë në funksion të projektit dhe përfituesit final janë grupet e interesit dhe komuniteti. Gjithashtu duhet të evidentojnë qartë impaktin e ndërhyrjes dhe procesin e vijimësisë duke u siguruar që investimi ti 'dorëzohet' zyrtarisht përfituesve fundorë të cilët do të jenë përgjegjës për mirëmbajtjen e mëtejshme.

Kur flasim për monitorimin e ujrave, flasim vetëm për ujrate e trupave ujore natyrore, të tipit ujrave të liqeneve, deteve, lumenjve, lagunave apo mund të bëhet dhe monitorimi i ujit që vjen në banesë, të sistemi i furnizimit me ujë, por jo vetëm cilësia por edhe humbja në rrjetin e furnizimit me ujë?

Dëshira jonë është që të monitorojmë cilësinë e ujit në mjedis, nëse ju monitoroni një burim ujor që përdoret për të furnizuar me ujë disa njësi administrative mund ta bëni, por nuk do të dëshironim të monitoroni cilësinë e ujit nga sistemi i furnizimit në ndërtesa. Gjithsesi nëse nisma është e mirëkonceptuar dhe interesante, do të merret parasysh, dhe përgjigja nuk mund të jetë apriori.

Kur flasim për monitorimet, përmenden 6 bashki, Tirana, Elbasan, Korçë, Shkodër, Durrës, Fier, është e domosdoshme të bëhet monitorimi tek të 6 këto bashki apo mund të dalë monitorimi përtej këtyre bashkive?

Minimalisht do të bëhen monitorimet tek këto 6 bashki, por nëse dëshironi monitorimi mund të shtrihet përtej këtyre bashkive.

Kur flasim për monitorimin e ndotjes në parqe urbane, shumica e parqeve urbane janë me sipërfaqe të betonizuar dhe mungojnë hapësirat e gjelbërta, a nuk do të ishin parqet rurale dhe ekosistemet më të përshtatshme për montorim?

Parqet që do merren në konsideratë për matjen e ndotjes së tokës do të jenë parqe urbane me bimësi, të cilat ndikohen nga ndoja urbane.

A mund të aplikoj në fazën e dytë të GreenAL me një nismë me të cilën kam fituar në fazën e parë të GreenAL, duke qenë se nisma është akoma e rëndësishme dhe efektive për komunitetn?

Nëse nisma sjell risi nuk do të paragjykohet vetëm për faktin që është financuar një herë nga GreenAL, por është e rëndësishme që aktivitetet mos të jenë përsëritje e të njëjtës nismë dhe të sjellin risi në krahasim me nismën e kaluar. Për sa kohë që ju e vlerësoni si praktikë të mirë dhe dëshironi ta risillni, mund ta bëni.

Kemi pasur një nisme për miratimin e një ligji për tokat bujqësore, me afat 12 muaj (plus 1 muaj shtesë). Mbas shumë vonesash procedurale, ligji u miratua një vit mbasi përfundimit të afatit të grantit. A do të ketë raste përjashtimore, në rastet kur nje kontratë granti lidhet për afatin maksimal të grantit, por procedura ka vonesa, do të kete zgjatje të afatit të grantit, apo afati është i përcaktuar dhe nuk ndryshon?

Nëse aplikimi i propozuar shpallet fitues ai do të monitorohet nga grupi i punës në GreenAL dhe nëse do të jetë nevoja për shtyrje të zbatimit të projektit për arritjen e objektivave apo për shkak të faktorëve të jashtë ato do të merren në konsideratë rast pas rasti. GreenAL sugjeron të gjithë aplikantët ti përmbahen afateve kohore të parashikuara për LOT 1 dhe 2.

A financon GreenAL zhvillime teknologjike të tipit aplikacione?

Nëse projekt propozimi është i bazuar i gjithi tek ndërtimi i një aplikacioni, atëhere ky projekt nuk është subjekt financimi nga GreenAL. Nëse, hipotetikiisht teknologjia do të vij në ndihmë të arritjes së objektivave të vendosur në projekt dhe ndihmon në arritjen e grupeve të interesit atëhere do të vlerësohet si të gjithë projektet e tjera në thirrje. Megjithatë kujtojmë se fokusi i GreenAL dhe i këtyre thirrjeve janë çështjet mjedisore.

Kontrata e grantit do të jetë në Lekë apo në Euro?

Kontrata e grantit do të jetë në Euro.

Kur themi që pagesat e personelit që punon në shtet janë të papranueshme, nëse bëjmë marrëveshje me një profesor që është i përfshirë në një universitet por nga ana tjetër ka dhe një NIPT dhe kontratën e marrëvesjes e lidh me personin fizik, a futet pagesa për të e tek pagesat e papranushme, apo jo?

Në këtë rast për sa kohë që marrëveshjen me këtë person ju e beni nëpërmje NIPT-it, i cili është një entitet juridik më vete. Personi ju lëshon një faturë tatimore, atëhere ju këtë person nuk e keni tek pagat e personelit por duhet ta keni tek pagesat e ekspertit, prandaj mund te quhet e lejueshme.

Propozimi është me dy faza, ku faza e parë është me koncept ide dhe faza e dyte është me propozimin e plotë. Kur flasim për buxhetin duhet të jetë buxheti i përfshirë që në fazen e aplikimit me koncept ide?

Në fazën e aplikimit me koncept ide buxheti do të paraqitet vetëm si shumë në total, jo i detajuar, por vlera totale gjatë aplikimit me propozim të plotë nuk mund të ndryshojë më shumë se 20% e vlerës së propozuar gjatë koncept idesë.

A ka një kufi limit se sa përqind e buxhetit duhet të zenë pagat e personelit?

Nuk ka një përqindje të përcaktuar sa do të zënë pagat e personelit.

A mund të kemi bashkëpunim me një organizatë të huaj, apo ekspertiza a mund të jetë e huaj?

Bashkëpunimi lejohet vetëm me organizata që operojnë dhe janë të regjistruara në Shqipëri, ndërsa sa për ekspertin e huaj, është e lejuar, por ashtu edhe si për ekspertët e tjerë do të duhet të përmendet vlera e shtuar që sjell ekspertiza e tij/saj në projekt.

Kriteret administrative të përzgjedhjes, a janë që në fazën e koncepti idesë, marrëveshje bashkëpunimi, etj?

Dokumentat administrative do tu kërkohen vetëm atyre aplikantëve të cilët do të ftohen për të dorëzuar projekt propozimin e plotë, megjithatë partneriteti patjetër që duhet të jetë i konsoliduar që në fazën e koncept idesë. Proceset administrative dhe dokumentacioni i nevojshëm është paraqitur tek Udhëzuesi me qëllim që të gjithë aplikantët potencial të familjarizohen me procesin dhe ti kenë etapat e qarta.

Shumë organizata kanë përditësuar kohë pas kohe vendimin gjyqësor, duke ripozicionuar profilin e tyre, ndoshta është më mirë që organizatat të dorëzojnë vendimin e gjykatës për 3 muajt e fundit?

Vendimi i gjykatës për formimin e organizatës, i shërben vlerësuesve për të validuar se kur kanë filluar aktivitetin. Një nga kushtet për aplikim është që organizatat të ketë minimalisht 5 vite eksperiencë nga regjistrimi në gjykatë. Sa për fushën e veprimtarisë ose profilin e organizatës përgjithësisht tek dokumentacioni i dorëzuar këto elementë janë të pasqyruara tek statuti dhe akti i themelimit.

Nëse një organizatë ka dëshirë të vijë me dy projekt propozime, vetëm një herë lejohet të aplikojë apo mund të aplikojë dy herë?

Organizatat të cilët duan të aplikojnë për LOT 1 mund të aplikojnë vetëm një herë në këtë thirrje dhe nuk mund të aplikojnë për të qenë aplikant kryesor ose bashkë-aplikant në LOT 2.

Organizatat të cilat duan të aplikojnë si aplikant kryesor për LOT 2 mund të aplikojnë vetëm një herë si të tillë dhe nuk mund të jenë bashkë-aplikant në një aplikim tjetër.

Organizatat të cilat duan të aplikojnë si bashkë-aplikant në LOT 2 mund të aplikojnë deri në dy herë si të tillë në këtë thirrje.

Aktorët me të cilat OSHC-të mund të lidhin partneritet (listuar në 2.2.3) nuk kanë kufizime për aplikimet e tyre.

Pyetje të tjera

Nëse je lider ose partner në thirrjen e granteve rajonale, a mund të marresh pjesë në grantet e iniciativës me projekt propozime?

Sa i përket Thirrjes së dytë të Granteve Rajonale dhe të Iniciatives, kriteret e përshtatshmërisë (eligibility) për aplikantët potencial do të vlerësohen nga grupi i punës në momentin e hartimit të thirrjes, e cila do të ndodhi rreth periudhës Mars-Prill 2025.

Ne jemi një shoqatë që ka pak muaj që është krijuar. Kemi mundësi të fitojmë një grant tematik apo rajonal nëse nuk përmbushim kriterin e eksperiencës?

Organizatata të cilat mund të aplikojnë në thirrje, si bashkëaplikant, duhet të kenë minimalisht 1 vit eksperiencë (1 vit nga regjistrimi në Gjykatë). Partnerët e GreenAL, përgjatë gjithë procesit do të sigurohen që të ketë një vlerësim objektiv, të paanshëm dhe profesional të aplikimeve të ardhura në thirrjet për grante.

A mund të shpjegoni se çfarë nënkupton hapsira 'Grupi i interesit/Mandatin që përfaqëson' tek formati i koncept idesë?

Hapsira "Grupi i interesit/Mandatin që përfaqëson" në dokumentin "Shtojca 1" nënkupton që organizata ose aplikanti duhet të përshkruajë se cilin grup të shoqërisë përfaqëson ose interesat e kujt përfaqëson dhe për çfarë qëllimi. Për shembull, nëse një organizatë që merret me mbrojtjen e mjedisit në zonën e Gjirokastrës aplikon, në këtë hapsirë të aplikimit mund të shkruajë: "Organizata jonë përfaqëson interesat e komunitetit të fermerëve të zonës Gjirokastrë, me qëllim përmirësimin e praktikave bujqësore të qëndrueshme dhe adresimin e çështjeve të ndotjes së ujit që ndikon në cilësinë e prodhimeve të tyre." Ky shembull tregon grupin e interesit (fermerët) dhe mandatin (mbrojtja e interesave për përmirësimin e praktikave bujqësore dhe mbrojtjen e cilësisë së ujit).

Për LOT 2, thuhet që partneriteti është i detyrueshëm me të paktën 2 OSHC. Kjo nënkupton që partneriteti është i detyrueshëm me 2 OSHC përveç organizatës aplikuese, apo me 2 organizata dhe një institucion shtetëror?

Aplikanti kryesor i cili ka dëshirë të aplikojë në LOT 2 duhet të formojë me doemos një partneritet i cili përfshin minimalisht 2 OSHC, pra partneriteti duhet të jetë midis 3 OSHC-ve në total. Institucionet publike mund të jenë pjesë e aplikimit si aplikant pa buxhet.